



BASHKIA MIRDITË

Nr. _____ prot

Datë: ____ .07.2025

L e n d a : Dërgojmë “Njoftim për publikim vende të lira pune ” në faqen tuaj

Agjencisë Kombëtare të Punësimit dhe Aftësive

Adresa : Bulevardi “B.Curri”, pranë ish – “Hotel Arbana”

T I R A N Ë

Bashkëngjitur Ju dërgojmë **“Njoftim për publikim vende të lira pune”** në Bashkinë Mirditë, për publikim në faqen tuaj, bazuar në ligjin nr. 139/2015 “Për Vetëqeverisjen Vendore në RSH-së”, në Kodin e Punës të RSH-së i ndryshuar, Vendimit nr.2, datë 08.01.2024 “Për miratimin e strukturës organike të Bashkisë Mirditë për vitin buxhetor 2024” i ndryshuar me urdhër Nr.4 datë 08.01.2025”.

Ndërkohë të njëjtat materiale janë dërguar në adresën tuaj elektronike nga “Njësia Përgjegjëse e Burimeve Njerëzore”

Duke Ju falenderuar për bashkëpunimin!

KRYETARI

ALBERT MËLYSHI



BASHKIA MIRDITË

Nr. _____ Prot

Datë ____ .07.2025

NJOFTIM
“Për vende të lira pune ”

Bazuar në ligjin nr. 139/2015 “Për Vetëqeverisjen Vendore në RSH-së”, në Kodin e Punës të RSH-së i ndryshuar, Vendimin nr.02 datë 08.01.2024 “Për miratimin e strukturës organike të Bashkisë Mirditë për vitin buxhetor 2024” i ndryshuar me urdhër Nr.4 datë 08.01.2025, Bashkia Mirditë shpall vende të lira pune për punonjës sezonal:

1 (një) pozicion “Punonjës/Mirëmbajtës të kanaleve vaditëse” - Njësia Administrative

Rrëshen

2 (dy) pozicione “Vrojtue sezonal të pyjeve”

I- PËRSHKRIMI I PUNËS

1. Mbajtja në funksion e kanaleve ujitës dhe depozitave të ujit;
2. Menaxhimin e përdorimit të ujit për ujitje;
3. Hapjen dhe mbylljen e prizave të ujit;
4. Shpërndarjen e ujit për ujitje, në bazë të kërkesave të fermerëve;
5. Manovrimin e saraçineskave për furnizimin me ujë të lagjeve të ndryshme;
6. Kontrollin e funksionimit të shkarkuesve të ujit;
7. Në zonat pyjore të caktuara nga specialistët për çlodhje, argëtim, turizëm dhe për pritjen e publikut, vrojtuesit pyjor caktojnë vendqëndrimet dhe rrugët e lëvizjes, si dhe vendet ku mund të lejohet ndezja e zjarreve;
8. Parandalon, zbulon rastet e dëmtimit, pushtimit, shpërdorimit, tjetërsimit, shkretimit dhe degradimit të pyjeve, tokës pyjore, kullotave dhe livadheve brenda territorit të tij administrativ;
9. Bashkëpunon me strukturat e ngarkuara me këtë ligj dhe ligje të posaçme, për parandalimin dhe shuarjen e zjarreve.
10. Njofton dhe bashkëpunon me specialistët e pyjeve për shkeljet që konstatohen në fondin pyjor kullësor;
11. Bashkëpunon me specialistët e pyjeve për përgatitjen e projekteve për ndërhyrjet në fondin pyjor kullësor;

12. Drejtojnë dhe mbikëqyrin përmirësimin e zonave të gërryera dhe luftojnë gërryerjen brenda territorit të njësisë;
13. Identifikon sëmundjet dhe dëmtuesit në fondin pyjor.

II- DOKUMENTACIONI, MËNYRA DHE AFATI I DORËZIMIT.

Kandidatët e interesuar duhet të dorëzojnë me postë apo drejtpërsëdrejti, në zyrën e protokollit pranë Bashkinë Mirditë, deri më dt. 21.07.2025 ora 15:00 dokumentet e mëposhtme:

1. Kërkesë personale/ letër motivimi për vendin e punës
2. CV (Curriculum vitae)
3. Vërtetim nga prokuroria
4. Vërtetim nga gjykata
5. Raport aftësie për punë
6. Dëshmi penaliteti, lëshuar nga Ministria e Drejtësisë
7. Dëftesë e Shkollës së Mesme (fotokopje e noterizuar)
8. Fotokopje e letërnjoftimit elektronik
9. Librezë pune
10. Fotografi (2 copë)

Mungesa e një prej dokumenteve apo pavlefshmëria e tyre, sjell mos kualifikimin e kandidatit.

III- KUSHTET QË DUHET TË PLOTËSOJË KANDIDATI

Kushtet që duhet të plotësojë kandidati për këtë pozicion pune janë:

- a) Të jetë shtetas shqiptar;
- b) Të ketë zotësi të plotë për të vepruar;
- c) Të zotërojë gjuhën shqipe, të shkruar dhe të folur;
- d) Të jetë në kushte shëndetësore që e lejojnë të kryejë detyrën përkatëse;
- e) Të mos jetë në proces procedimi apo shqyrtimi penal në prokurori apo gjykatë;
- f) Të mos jetë i dënuar me vendim të formës së prerë për kryerjen e një krimi apo për kryerjen e një kundërvajtjeje penale me dashje;

Intervista do të zhvillohet me datë 24.07.2025, ora 10:00, në sallën e mbledhjeve të Këshillit Bashkiak, me adresë: Sheshi “Abat Doçi”, pranë “Godina e Shërbimit të Qytetarëve”, kati I-rë.

Për çdo paqartësi apo detaje më të hollësishme paraqituni pranë Njësine Përgjegjëse të Burimeve Njerëzore, Bashkia Mirditë.

BASHKIA MIRDITË
(Njësia Përgjegjëse e Burimeve Njerëzore)